

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
DEPARTAMENTI: FINANCIAR



RREGULLIMET LIGJORE DHE SFIDAT NË ZBATIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Shkalla Master

Mentori:
Prof. Dr. Artor NUHIU

Kandidatja:
Natyrë ADEMI

Prishtinë, 2024

ABSTRAKT

Auditimi i brendshëm kryhet në mjedise të ndryshme ligjore dhe kulturore; brenda organizatave që ndryshojnë për nga qëllimi, madhësia, kompleksiteti dhe struktura dhe nga persona brenda apo jashtë organizatës. Ndërkohë që dallimet mund të ndikojnë në praktikën e auditimit të brendshëm në secilin mjedis, përputhshmëria me Standardet ndërkombëtare të IAB mbi praktikën profesionale të auditimit të brendshëm (Standardet) është thelbësore për përmbushjen e përgjegjësive të autorëve të brendshëm dhe për aktivitetin e auditimit të brendshëm.

Misioni, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm duhet të përcaktohen zyrtarisht në statutin për auditim të brendshëm, në përputhje me Misionin e Auditimit të Brendshëm dhe elementet e detyrueshme të Kornizës së Praktikave Profesionale Ndërkombëtare (Parimet themelore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet dhe përkufizimin e auditimit të brendshëm).